



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 232

Tiranë – E enjte, 1 dhjetor 2016

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, datë 6.10.2016	24219
Çështja Jani Mihani kundër Shqipërisë (ankimi nr. 47760/09).....	
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, datë 6.10.2016	24221
Çështja Shehu kundër Shqipërisë (ankimi nr. 33704/09).....	
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, datë 6.10.2016	24224
Çështja Brahimaj kundër Shqipërisë (ankimi nr. 4801/13).....	
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, datë 8.9.2016	24226
Çështja Qerimi dhe Canaj kundër Shqipërisë (ankimet nr. 12878/10 dhe 74858/12).....	



GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE  
TË NJERIUT  
SEKSIONI I PARË

**VENDIM**  
**Ankimi nr. 47760/09**

**Jani Mihani kundër Shqipërisë**

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Parë), e mbledhur më 13 shtator 2016, si një Komitet i përbërë nga:

Kristina Pardalos, *presidente*

Robert Spano,

Pauline Koskelo, *gjykatës,*

dhe Renata Gegener, *zëvendësregjistare e Seksionit,*

Në lidhje me ankimin e më sipërm të paraqitur më 29 gusht 2009,

Në lidhje me deklaratën e paraqitur nga Qeveria e paditur, më 22 prill 2013, e cila i kërkonte Gjykatës të përjashtonte ankimin nga lista e çështjeve, si dhe në lidhje me përgjigjen e ankuesit për atë deklaratë,

Pasi ka diskutuar, vendos si më poshtë vijon:

**FAKTET DHE PROCEDURA**

Ankuesi, z. Jani Mihani, është një shtetas shqiptar, i cili ka lindur në vitin 1961 dhe jeton në Kavajë.

Qeveria shqiptare (“Qeveria”) u përfaqësua nga agjenti i saj i asaj kohe, znj. L. Mandia nga Zyra e Avokatit të Shtetit.

Fillimisht ankuesi shprehu pakënaqësinë se kishte ishin shkelur nenet 6 § 1 dhe 13 të Konventës, si edhe neni 1 i protokollit nr. 1 i Konventës për shkak të moszbatimit të një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Gjithashtu, ai u ankua bazuar në nenin 8 të Konventës, i cili iu komunikua Qeverisë.

**Rrethanat e çështjes**

Më 20 tetor 2005, ankuesi mori një leje ndërtimi, e vlefshme deri më 28 dhjetor 2006.

Më 31 janar 2008, Bashkia e Kavajës (“Bashkia”) vendosi të rrëzonte kërkesën e ankuesit për shkakun se ai nuk kishte justifikim të arsyeshëm për të vonesën në fillimin e punimeve të ndërtimit.

Më 18 qershor 2008, Gjykata e Rrethit Durrës e anuloi vendimin dhe urdhëroi zgjatjen e vlefshmërisë së lejes. Më 14 prill 2009, Gjykata e Apelit Durrës la në fuqi vendimin e gjykatës më të ulët. Më 13 maj 2009, u lëshua një urdhër zbatimi.

Më 2 dhjetor 2011, Bashkia vendosi të zgjaste vlefshmërinë e lejes së ndërtimit.

Më 12 dhjetor 2011, zyra përmbarimore i ndërpreu procedurat e zbatimit me argumentin se vendimi i formës së prerë ishte zbatuar plotësisht. Ankuesi kishte tërhequr një kërkesë për kostot dhe shpenzimet.

Më 17 qershor 2012, ankuesi informoi Gjykatën se tashmë kishte filluar punimet konform vendimit të bashkisë duke e zgjatur vlefshmërinë e lejes së ndërtimit.

**LIGJI**

**A. Në lidhje me nenet 6 § 1 dhe 13 të Konventës dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës**

Ankuesi shprehu pakënaqësinë bazuar në nenet 6 § 1 dhe 13 të Konventës dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës për zbatimin e vonuar të vendimit të formës së prerë.

Pasi nuk u arrit një zgjidhje miqësore, me anë të një letre të datës 22 prill 2013, Qeveria informoi Gjykatën se propozonte të bëhej një deklaratë njëpalëshe për zgjidhjen e çështjes së ngritur nga kjo pjesë e ankimit. Më tej, Qeveria i kërkoi Gjykatës që të përjashtonte ankimin në përputhje me nenin 37 të Konventës.

Në deklaratë shpjegohej si më poshtë:

“Qeveria e Shqipërisë ofron t’i paguajë z. Jani Mihanit 1,000 euro *ex gratia* për të mbuluar çdo dhe të gjithë dëmet jomonetare, si edhe kostot dhe shpenzimet, plus çdo taksë, e cila mund t’i tarifohej ankuesit.

Qeveria e Shqipërisë pranon zgjatjen e paarsyeshme të procedurave vendase, në të cilat u përfshi ankuesi, dhe shpreh keqardhjen për vonesën në ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Apelit, Durrës, vendimi me nr. 138, i datës 14 prill 2009.

Shuma e sipërpërmendur i akordohet ankuesit, fillimisht duke pasur parasysh se vendimi është ekzekutuar dhe së dyti se ankuesi ka hequr dorë nga zbatimi i urdhrit në kushtet kur ai është ekzekutuar plotësisht.

Kjo shumë do të konvertohet në vlerën monetare vendase në normën e zbatueshme në datën e pagesës dhe do të paguhet brenda tre muajve nga data e shpalljes së vendimit të marrë nga Gjykata për ta përjashtuar çështjen nga lista e saj e çështjeve. Në rastin kur nuk kjo shumë nuk paguhet brenda periudhës prej tre muajsh, Qeveria ndërmerr të paguajë një interes të thjeshtë për të, nga përfundimi i asaj periudhe deri në zgjidhje, në një normë të barasvlefshme me normën marxhinale të huadhënies të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit plus pikë tre përqindëshe.



Pagesa do të përbëjë zgjidhjen përfundimtare të çështjes”.

Në letrën e tij të datës 25 maj 2013, ankuesi pohon se nuk ishte i kënaqur me kushtet e deklaratës njëpalëshe, sepse dëmi monetar që kishte kërkuar ishte më i lartë sesa shuma e ofruar nga Qeveria.

Gjykata kujton se neni 37 i Konventës parashikon se ajo mund të vendosë të përjashtojë një ankim nga lista e saj e çështjeve në çdo fazë të procedimeve, kur rrethanat çojnë në një nga rezultatet e specifikuar sipas shkronjave (a), (b) ose (c) të paragrafit 1 të atij neni. Neni 37 § 1 (c) i jep të drejtën Gjykatës specifikuat të përjashtojë një çështje nga lista e saj “për çdo arsye tjetër të përcaktuar nga Gjykata, kur shqyrtimi i ankimit nuk është më i justifikueshëm për t’u vazhduar”.

Gjithashtu, ajo thekson se në rrethana të caktuara, ajo mund ta përjashtojë një ankim sipas nenit 37 § 1 (c) në bazë të një deklaratë të njëanshme nga Qeveria e paditur, edhe nëse ankuesi dëshiron që të vazhdohet më shqyrtimin e çështjes.

Për këtë qëllim, Gjykata ka shqyrtuar deklaratën sipas parimeve që dalin nga praktika e saj gjyqësore, veçanërisht në çështjet *Vendimi Tabsin Acar (Tabsin Acar kundër Turqisë* (kundërshti paraprake) [GJP], nr. 26307/95, §§ 75–77, GJEDNJ 2003–VI; *WAZA Sp. z.o.o. kundër Polonisë* (vendim), nr. 11602/02, 26 qershor 2007; dhe *Subwinska kundër Polonisë* (vendim), nr. 28953/03, 18 shtator 2007).

Në një sërë rastesh, duke përfshirë edhe ato të paraqitura kundër Shqipërisë, Gjykata ka përdorur praktikën e saj në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës për moszbatim të vendimeve të formës së prerë të gjykatës (shiko *Gjyli kundër Shqipërisë*, nr. 32907/07, §§ 19–28, 29 shtator 2009; dhe *Luli dhe tjerët kundër Shqipërisë*, nr. 64480/09, 64482/09, 12874/10, 56935/10, 3129/12 dhe 31355/09, §§ 63–64, 1 prill 2014).

Gjykata vëren se pavarësisht përdorimit të shprehjes *ex gratia*, deklarata e njëanshme e Qeverisë përmban një pranim të shkeljes së neneve 6 dhe 13 të Konventës dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës, dhe se shuma e parave të ofruara synon të kompensojë ankuesin për dëmin e vuajtur si rezultat i zbatimit të vonuar të vendimit të formës së prerë.

Duke iu referuar natyrës së pranimeve të

pranuara në deklaratën e Qeverisë, si edhe shumën e kompensimit të propozuar – e cila është në përputhje me shumën e ofruara në çështje të ngjashme – Gjykata mendon se nuk është e justifikueshme të vazhdojë më tej me shqyrtimin e ankimit (nenet 37 § 1 (c)).

Në vijim, duke u bazuar në shqyrtimet e mësipërme, dhe veçanërisht duke marrë në konsideratë praktikën gjyqësore të qartë dhe gjithëpërfshirëse mbi tematikën, Gjykatës i garantohet respekt për të drejtat e njeriut siç përcaktohet në Konventë dhe në protokolle, dhe për këtë arsye nuk i kërkohet të vazhdojë me shqyrtimin e ankimit (neni 37 § 1 *in fine*).

Së fundmi, Gjykata thekson se nëse Qeveria nuk përmbush kushtet e deklaratës së saj të njëanshme, ankimi mund të rikthehet në listë në zbatim të nenit 37 § 2 të Konventës (*Josipović kundër Serbisë* (vendim), nr. 18369/07, 4 mars 2008).

Nga sa u përmend më sipër, është gjëja e duhur që çështja të hiqet nga lista, bazuar në ankimet sipas neneve 6 § 1 dhe 13 të Konventës, si dhe me nenin 1 të protokollit nr. 1 të Konventës.

## B. Në lidhje me nenin 8 të Konventës

Duke u mbështetur në nenin 8 të Konventës, ankuesi shprehu pakënaqësinë edhe për shkelje të nenit 8 të Konventës për arsye se moszbatimi nga ana e autoriteteve të vendimit të formës së prerë në kohën e duhur kishte shkelur të drejtën e tij për jetë familjare.

Gjykata vëren se ankuesi nuk paraqiti ndonjë procedurë vendase në lidhje me ankimin e tij dhe për këtë arsye nuk ka paraqitur përpara autoriteteve kombëtare thelbin e ankimit të tij. Sipas kësaj pike, kjo pjesë e ankimit duhet rrëzuar për mosshfrytëzim të masave vendase, sipas nenit 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime:

*Merr parasysh* kushtet e deklaratës së Qeverisë së paditur sipas neneve 6 § 1 dhe 13 të Konventës, si dhe të nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës dhe të modaliteteve për garantimin e respektimit të premtimeve të përmendura këtu;

*Vendos* ta heq pjesën korresponduese të ankimit nga lista e çështjeve në përputhje me nenin 37 § 1 (c) të Konventës.

*E deklaron* pjesën e mbetur të ankimit të papranueshme.



E përgatitur në anglisht dhe e shpallur me shkrim më 6 tetor 2016.

**Renata Degener**  
Zëvendësregjistrare  
(*firmosur*)

**Kristina Pardalos**  
Presidente  
(*firmosur*)

#### SEKSIONI I KATËRT

ÇËSHTJA MIHANI KUNDËR SHQIPËRISË  
(*Ankimi nr. 47760/09*)

#### DEKLARATË NJËPALËSHE

Unë deklaroj se Qeveria e Shqipërisë ofron t'i paguajë *ex gratia* z. Jani Mihani 1000 euro për të mbuluar çdo dhe të gjithë dëmin jomonetar, si edhe kostot dhe shpenzimet, plus çdo taksë që mund t'i tarifohet ankuesit.

Qeveria e Shqipërisë pranon kohëzgjatjen e paarsyeshme të procedurave vendase, në të cilat u përfshi ankuesi dhe shpreh keqardhjen për vonesën në ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës, nr. 138, në datën 14.4.2009.

Shuma e sipërpërmendur i ofrohet ankuesit, duke marrë në konsideratë fillimisht faktin se vendimi është ekzekutuar dhe së dyti se ankuesi kishte hequr dorë nga zbatimi i urdhrit gjyqësor në kushte kur ai është ekzekutuar plotësisht.

Kjo shumë do të konvertohet në vlerën monetare vendase në normën e zbatueshme në datën e pagesës dhe do të paguhet brenda tre muajve nga data e shpalljes së vendimit të marrë nga Gjykata për të nxjerrë çështjen nga lista e saj e çështjeve. Në rast se kjo shumë nuk paguhet brenda periudhës së premtuar prej tre muajsh, Qeveria premton të paguajë interesin e thjeshtë mbi të, nga përfundimi i asaj periudhe deri në zgjidhje, në një normë të barabartë me normën marxhinale të huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së vonesës plus pikë tre përqindëshe. Pagesa do të përbëjë zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

Për Qeverinë

**Lediana Mandia**

Avokate e Përgjithshme e Shtetit  
(*firmosur, vulosur*)

Tiranë, më 22 prill 2013

#### GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT SEKSIONI I PARË

ÇËSHTJA SHEHU KUNDËR SHQIPËRISË  
(*Ankimi nr. 33704/09*)

**VENDIM  
STRASBURG  
6 tetor 2016**

Ky vendim është i formës së prerë, por mund të bëhet objekt i rishikimit redaktues.

Në çështjen Shehu kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ((Seksioni i parë) Seksioni i Parë), e mbledhur si një Komitete i Përbërë nga:

Kristina Pardalos, *presidente*

Robert Spano,

Pauline Koskelo, *gjykatës,*

dhe Renata Gegener, *zëvendësregjistrare* e Seksionit,

Pas një diskutimi me dyer të mbyllura më 13 shtator 2016,

Lëshon vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë datë:

#### PROCEDURA

1. Çështja filloi më 19 maj 2009 me një ankim (nr. 33704/09) kundër Republikës së Shqipërisë paraqitur në Gjykatë nga një shtetase shqiptare, znj. Përpraimë Shehu ("ankuesja") sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa").

2. Qeveria shqiptare ("Qeveria") u përfaqësua nga Agjencia e saj e asaj kohe znj. L.Mandia nga Zyra e Avokatit të Shtetit.

3. Më 10 korrik 2012, ankimi iu komunikua Qeverisë.

#### FAKTET

##### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

4. Ankuesja ka lindur në vitin 1947 dhe jeton në Tiranë.

5. Me anë të një vendimi të formës së prerë, i datës 21 qershor 1996, Gjykata e Rrethit Tepelenë, urdhëroi Këshillin e Rrethit Tepelenë t'i paguante ankueses 530,941 lekë shqiptarë (TË GJITHA), si kompensim për marrjen e shtëpisë së saj nga Shteti në vitin 1967. Vendimi u bë i formës së prerë në një datë të papërcaktuar në vitin 1996.



6. Më 15 korrik 1998, u lëshua një urdhër zbatimi nga gjykata.

7. Me anë të një vendimi të formës së prerë, të datës 25 prill 2008, Gjykata e Rrethit Gjirokastrë, urdhëroi Këshillin e Qarkut Gjirokastrë t'i paguante ankueses 1,237,336 TË GJITHA si një kompensim për zbatimin e vonuar të vendimit të Gjykatës së Rrethit Tepelenë, të datës 21 qershor 1996. Vendimi u bë i formës së prerë më 25 maj 2008.

8. Më 27 qershor 2008, u lëshua një urdhër zbatimi nga gjykata.

9. Nga 1996 deri në vitin 2009, ankuesi i kishte dërguar vazhdimisht letra autoriteteve për zbatimin e vendimeve të formës së prerë. Gjithashtu, ajo kishte ndërmarrë procedurat zbatuese me anë të një përmbarduesi.

10. Më 23 janar 2009, Gjykata Kushtetuese pranoi se kishte pasur një shkelje për një gjykim të drejtë si rezultat i moszbatimit të vendimeve të formës së prerë.

11. Më 8 dhjetor 2009, të dy vendimet u zbatuan dhe ankueses iu paguan shumat.

## II. LIGJI DHE PRAKTIKA PËRKATËSE VENDASE

12. Ligji dhe praktika përkatëse vendase janë përshkruar në çështjet *Qufaj Co. sh.p.k. kundër Shqipërisë* (nr. 54268/00, §§ 21–26, 18 nëntor 2004) dhe *Gjyli kundër Shqipërisë* (nr. 32907/07, §§ 19–28, 29 shtator 2009).

### LIGJI

#### I. SHTRIRJA E ÇËSHTJES

13. Në ankimin e saj fillestar në Gjykatë, ankuesja pretendonte se kishte pasur shkelje të neneve 6 § 1 të Konventës dhe të nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës në lidhje me kohëzgjatjen e procedimeve të zbatimit të vendimeve të formës së prerë të datës 21 qershor 1996 dhe 25 prill 2008. Më 21 qershor 2013, ankuesja dorëzoi kërkesat e saj për kompensim të drejtë së bashku me ankesat shtesë për moszbatim të një vendimi vendas së formës së prerë të datës 24 janar 2009, që i akordonte asaj kompensim në vend të rikthimit të pronës së saj së trashëguar.

14. Gjykata vëren se kërkesa e re e ankueses, më datë 21 qershor 2013, nuk i ishte komunikuar palëve, duke qenë se nuk ishte përfshirë në formularin e ankimit. Në këtë mënyrë, shtrirja e çështjes përpara Gjykatës është e kufizuar brenda

afatit të procedurave të zbatimit, siç u komunikua nga Qeveria, më 10 korrik 2012, sipas Rregullit 54 § 2 (b) të Rregullores së Gjykatës.

## II. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

15. Ankuesja paraqiti shqetësimin se kohëzgjatja e procedurave të zbatimit nuk respektoi kërkesën për “kohë të arsyeshme”, parashtruar në nenin 6 § 1 të Konventës, i cili për sa ka të bëjë me çështjen, parashikon si më poshtë:

“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ... çdokush ka të drejtën për një seancë dëgjimore ... të drejtë ... nga [një] ... gjykatë ...”

16. Qeveria u mbështet në faktin se kishte pasur një mosmarrëveshje midis autoriteteve shtetërore për përgjegjësinë e tyre për të zbatuar vendimin, dhe për faktin se ankuesja nuk kishte paguar brenda afatit të duhur taksën për përmbardimin. Qeveria argumentoi se nuk kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

#### A. Pranueshmëria

17. Gjykata vëren se kjo ankesë nuk është e pabazuar në fakte sipas interpretimit të nenit 35 § 3 (a) të Konventës. Më tej ajo vëren se ajo nuk është e papranueshme për ndonjë arsye tjetër. Kështu, ajo duhet deklaruar e pranueshme.

#### B. Cilësitë

18. Gjykata vëren se periudha për shqyrtim fillonte në një datë të papërcaktuar në vitin 1996, kur vendimi i Gjykatës së Rrethit Tepelenë, i datës 21 qershor 1996 u bë i formës së prerë (shiko *Gjyli kundër Shqipërisë, cituar më sipër*, § 33). Ai përfundoi më 8 dhjetor 2009, kur u zbatua plotësisht. Procedurat e zbatimit zgjatën trembëdhjetë vjet dhe pothuajse gjashtë muaj. Vendimi i formës së prerë i datës 25 prill 2008, njohu interesin e rritur si rezultat i moszbatimit të vendimit të formës së prerë të datës 21 qershor 1996 dhe u zbatua pas një viti dhe gjashtë muajsh.

19. Më tej, Gjykata vëren se Qeveria nuk ofroi shpjegime bindëse për këtë periudhë të tejkzatur pasiviteti dhe vonese të zbatimit të vendimit të formës së prerë të datës 21 qershor 1996. Në të vërtetë, ndryshe nga sa u parashtrua (shiko paragrafin 16 më sipër), vonesa në procedurat e zbatimit duket të jetë shkaktuar nga vetë autoritetet, dhe jo nga fakti se ankuesja nuk kishte paguar taksën e përmbardimit në afatin e duhur. Nuk ka asnjë tregues se pasiviteti dhe vonesa u shkaktuan për shkak të kompleksitetit të çështjes apo për



shkak të sjelljes së ankuesit. Përkundrazi, ankuesja e kërkoi zbatimin e vendimit të formës së prerë në favor të saj disa herë (shiko paragrafin 9 më sipër).

20. Tashmë, Gjykata ka gjetur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në çështjet e procedurave civile ku evidentohen problematika të ngjashme me atë në çështjen konkrete (shiko *Luli dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, nr. 64480/09, 64482/09, 12874/10, 56935/10, 3129/12 dhe 31355/09, 1 prill 2014; dhe *Gjyli*, cituar më sipër, §§ 43–47).

21. Sipas të gjithë materialit të dorëzuar përpara saj, Gjykata është e mendimit se Qeveria nuk ka paraqitur fakte apo argumente për ta bindur atë që të marrë një vendim tjetër për çështjen konkrete. Duke pasur parasysh praktikën ligjore për subjektin, ajo vendos se kohëzgjatja e procedurave të zbatimit për vendimin e formës së prerë, të datës 21 qershor 1996, ishte shtyrë shumë dhe nuk kishte respektuar kërkesën për “kohë të arsyeshme”.

### III. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR. 1 TË KONVENTËS

22. Ankuesja u ankua edhe për kohëzgjatjen e procedurave të zbatimit sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës, i cili përcakton si më poshtë vijon:

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.

23. Qeveria parashtroi faktin se duke qenë se shumata e akorduara me anë të vendimeve të formës së prerë ishin paguar të plota, ankesa sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 ishte e bazuar në fakte.

24. Duke pasur parasysh faktin se shumata e akorduara sipas vendimeve të formës së prerë ishin paguar, sipas nenit 6 § 1 të Konventës (shiko paragrafin 21 më sipër), bazuar në gjetjet e saj, Gjykata është e mendimit se nuk është e nevojshme të shqyrtohet çështja sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës.

### IV. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

25. Neni 41 i Konventës parashikon si më poshtë vijon:

“Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj, dhe nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesëshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.”

#### A. Dëmi

26. Ankuesja kërkoi 200,000 euro (EUR) për dëmin monetar për sa ka të bëjë me shtëpinë, e cila i kaloi shtetit në vitin 1967 dhe 300,000 EUR për dëmin jomonetar.

27. Qeveria i kundërshtoi këto kërkesa.

28. Gjykata nuk dallon ndonjë lidhje rastësore midis shkeljes së konstatuar dhe dëmit monetar të pretenduar, për këtë arsye ajo e hedh poshtë këtë kërkesë. Nga ana tjetër, Gjykata është e mendimit se ankuesja duhet të kishte mbështetur dëmin jomonetar. Duke marrë një vendim mbi një bazë të drejtë, nën këtë frymë, Gjykata i akordon asaj 3,300 EUR.

#### B. Kostot dhe shpenzimet

29. Ankuesja kërkoi edhe 100,000 EUR për kostot dhe shpenzimet e bëra në gjykatat vendase dhe në Gjykatën e Strasburgut.

30. Qeveria e kundërshtoi kërkesën.

31. Duke pasur parasysh faktin se ankuesja nuk paraqiti dokumente mbështetëse për kostot dhe shpenzimet, Gjykata nuk akordon asgjë për këtë gjë.

#### C. Interes i vonuar

32. Gjykata vendos që norma e interesit të vonuar duhet të bazohet në normën huadhënëse marxhinale të Bankës Qendrore Evropiane, së cilës i duhen shtuar pikë tre përqindëshe.

### PËR KËTO ARSYE, NË MËNYRË UNANIME, GJYKATA

1. E deklaron ankimin të pranueshëm;
2. Vendos se ka pasur një shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës për sa i përket kohëzgjatjes së procedurave të zbatimit;
3. Vendos se nuk është e nevojshme që çështja të shqyrtohet nën nenin 1 të protokollit nr. 1 të Konventës;
4. Vendos



a) se Shteti i paditur, brenda tre muajve, duhet t'i paguajë ankueses 3,300 EUR (tre mijë e treqind euro) për dëmin monetar plus çdo taksë që mund të tarifohet, të cilat duhen konvertuar në vlerën monetare të Shtetit të paditur, në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes;

b) se që nga përfundimi i tre muajve të përmendur më sipër deri në shlyerje, interesi i thjeshtë duhet të paguhet në shumën e më sipërme, në një normë të barasvlefshme me normën huadhënëse marxhinale të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së vonësës së pagesës plus pikë tre përqindëshe;

5. Rrëzon pjesën tjetër të kërkesës së ankueses për kompensim të drejtë.

E përgatitur në anglisht dhe njoftuar me shkrim, më 6 tetor 2016, sipas Rregullit 77 § 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

**Renata Degener**  
Zëvendësregjistruese  
(*firmosur*)

**Kristina Pardalos**  
Presidente  
(*firmosur*)

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE  
TË NJERIUT  
SEKSIONI I PARË

**ÇËSHTJA BRAHIMAJ KUNDËR  
SHQIPËRISË  
(Ankimi nr. 4801/13)**

**VENDIM  
STRASBURG  
6 tetor 2016**

Ky vendim është i formës së prerë, por mund të bëhet objekt i rishikimit redaktues.

Në çështjen Brahimaj kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Parë), e mbledhur si një Komitet i Përbërë nga:

Kristina Pardalos, *presidente*

Aleš Pajchal,

Robert Spano, *gjykatës,*

dhe Renata Gegener, *zëvendësregjistruare e Seksionit,*

Pas një diskutimi me dyer të mbyllura më 13 shtator 2016,

Lëshon vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë datë:

**PROCEDURA**

1. Çështja filloi më 8 janar 2013, me një ankim (nr. 4801/13) nga një shtetas shqiptar, z. Gëzim Brahimaj (“ankuesi”) kundër Republikës së Shqipërisë, të paraqitur në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen dhe të Drejtat e Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”).

2. Qeveria shqiptare (“Qeveria”) u përfaqësua nga Agjentja e saj znj. A. Hicka, nga Zyra e Avokatit të Shtetit.

3. Më 22 shtator 2014, ankimi iu komunikua Qeverisë.

4. Qeveria nuk paraqiti vërejtje për pranueshmërinë dhe cilësitë e çështjes brenda afatit kohor të lejuar.

5. Ankuesi nuk paraqiti kërkesa për kompensim të drejtë brenda afatit kohor të lejuar (Rregulli 60 i Rregullores së Gjykatës).

**FAKTET**

**I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

6. Ankuesi ka lindur në vitin 1968 dhe jeton në Vlorë.

7. Më 30 maj 2007, Gjykata e Rrethit Vlorë urdhëroi Policinë e Ndërtimit Dega Vlorë t'i paguante ankuesit 2,795,956 lekë shqiptarë (“TË GJITHA”) për prishjen e pajustificuar të pronës së tij.

8. Më 11 qershor 2008, vendimi u la në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë dhe u bë i formës së prerë.

9. Më 11 shtator 2008, u lëshua një urdhër gjyqësor për zbatim.

10. Nga viti 2009 deri në vitin 2012, përmbarimi kërkoi por pa sukses zbatimin e vendimit nga Policia e Ndërtimit Vlorë dhe nga Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar.

11. Deri më sot, vendimi i formës së prerë ka mbetur i pazbatuar.

**II. LIGJI DHE PRAKTIKA PËRKATËSE VENDASE**

12. Ligji dhe praktika përkatëse vendase janë përshkruar në çështjet *Qufaj Co. sh.p.k. kundër Shqipërisë* (nr. 54268/00, §§ 21–26, 18 nëntor 2004) dhe *Gjyli kundër Shqipërisë* (nr. 32907/07, §§ 19–28, 29 shtator 2009).

13. Përveç praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave të përmendura në vendimin e



Gjykatës në çështjen *Luli dhe të tjerët kundër Shqipërisë* (nr. 64480/09, 64482/09, 12874/10, 56935/10, 3129/12 dhe 31355/09, 1 prill 2014), Gjykata Kushtetuese ka lëshuar tre vendime të njëpasnjëshëm, ku konstaton një shkelje të të drejtave të paditësit për sa i përket procedurave gjyqësore të ndërprera (vendimet nr. 3/15, të datës 26 janar 2015; 56, të datës 21 korrik 2015 dhe 69/15, të datës 17 nëntor 2015). Paditësit nuk iu dha asnjë shpërblim për ato vendime.

14. Më tej, Gjykata Kushtetuese ka rikonfirmuar praktikën e vet të gjatë ku gjen shkeljen e të drejtave të paditësit për kohëzgjatjen e procedurave të moszbatimit (vendimet nr. 9/14, të datës 27 shkurt 2014; 16/14, të datës 21 mars 2014; 32/14, të datës 26 maj 2014; 46/14 dhe 47/14, më 30 korrik 2014; 14/15, më 30 mars 2015; 24/15, më 27 prill 2015; 25/15, më 22 maj 2015; 52/15, më 20 korrik 2015; 61/15, më 23 shtator 2015; 72/15, më 27 nëntor 2015). Paditësit nuk iu dha asnjë shpërblim në këto vendime dhe as ndonjë formë tjetër kompensimi për moszbatimin e vazhduar.

## LIGJI

### I. SHKELJE E PRETENDUAR E NENEVE 6 § 1 DHE 13 TË KONVENTËS

15. Ankuesi shprehu pakënaqësinë se moszbatimi i vendimit të Gjykatës së Rrethit Vlorë, i datës 30 maj 2007, ashtu siç u la në fuqi me anë të vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, më 11 qershor 2008, shkelte të drejtat e tij sipas neneve 6 § 1 dhe 13 të Konventës, të cilat parashikojnë si më poshtë:

#### Neni 6 § 1

“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ... çdokush ka të drejtën për një seancë dëgjimore ... të drejtë ... nga [një] ... gjykatë ...”

#### Neni 13

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”

16. Qeveria nuk paraqiti vërejtje për pranueshmërinë dhe cilësitë e çështjes brenda afatit kohor të lejuar (shiko, gjithashtu, paragrafin 4 më sipër).

### A. Pranueshmëria

17. Gjykata vëren se ankesa nuk është e pabazuar në fakte sipas kuptimit të nenit 35 § 3 (a) të Konventës. Më tej, ajo vëren se ajo nuk është e

papranueshme për ndonjë arsye tjetër. Për këtë arsye duhet të deklarohet e pranueshme.

### B. Cilësitë

18. Gjykata rithekson parimet e përgjithshme sipas nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me moszbatimin e vendimit të formës së prerë të gjykatës, të cilat parashikohen *inter alia* në *Qufaj Co. sh.p.k.* (cituar më sipër, § 38) dhe në çështjen *Gjyli* (cituar më sipër, §§ 43–44).

19. Gjithashtu, Gjykata i referohet vendimeve të saj të mëparshme duke konstatuar se në Shqipëri nuk ekziston asnjë kompensim efektiv në lidhje me zbatimin e vonuar ose me moszbatimin e vendimit të formës së prerë të gjykatës (shiko *Gjylin*, cituar më sipër, §§ 55–60; *Puton dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, nr. 609/07; §§ 33–35, 20 korrik 2010; dhe *Luli dhe të tjerët*, cituar më sipër, §§ 77–84). Duke iu referuar edhe praktikës gjyqësore më të fundit të Gjykatës Kushtetuese, siç përcaktohet më sipër në paragrafët 13–14, Gjykata konstaton se nuk ka pasur dhe ende nuk ka asnjë kompensim efikas për ankuesin në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave të moszbatimit.

20. Duke pasur parasysh praktikën e saj gjyqësore të mirëpërcaktuar mbi objektin (*Qufaj Co. sh.p.k.*, cituar më sipër; *Gjyli*, cituar më sipër; *Puto dhe të tjerët*, cituar më sipër; dhe *Luli dhe të tjerët*, cituar më sipër), Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës për sa i përket moszbatimit të vendimit të formës së prerë dhe një shkelje të nenit 13 të Konventës për arsye se ankuesi nuk mori një shpërblim efikas kombëtar si shlyerje për dëmin e shkaktuar nga moszbatimi.

### II. ZBATIMI NENIT 41 TË KONVENTËS

21. Neni 41 i Konventës parashikon si më poshtë vijon:

“Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj, dhe nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.”

22. Ankuesi nuk paraqiti kërkesa për kompensim të drejtë brenda afatit kohor të lejuar. Për pasojë, nuk duhet akorduar asnjë dëm monetar. Megjithatë, duke pasur parasysh natyrën e shkeljes së Konventës së konstatuar, Qeveria e paditur duhet të garantojë zbatimin e vendimit të formës së prerë në çështjen e ankuesit brenda tre muajve në përputhje me nenin 28 § 2 të Konventës (shiko për





shembull, *Vukelić kundër Malit të Zi*, nr. 58258/09, § 107, 4 korrik 2013; *Mikhaylova dhe të tjerët kundër Ukrainës*, nr. 16475/02, § 40, 15 qershor 2006; dhe *Lisjanskij kundër Ukrainës*, nr. 17899/02, § 34, 4 prill 2006).

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË  
MËNYRË UNANIME:

1. E deklaroi ankimin të pranueshëm;
2. Vendos se ka pasur një shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës për sa i përket moszbatimit të vendimit vendas së formës së prerë;
3. Vendos se ka pasur një shkelje të nenit 13 të Konventës për sa i përket mungesës së një kompensimi për moszbatimin e vendimit;
4. Vendos se Shteti i paditur duhet të sigurojë, me anë të mënyrave të duhura, zbatimin e vendimit të formës së prerë të dhënë në favor të ankuesit, brenda tre muajve në përputhje me nenin 28 § 2 të Konventës.

E përgatitur në anglisht dhe njoftuar me shkrim, më 6 tetor 2016, sipas Rregullit 77 § 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

**Renata Degener**  
Zëvendësregjistruese  
(*firmosur*)

**Kristina Pardalos**  
Presidente  
(*firmosur*)

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE  
TË NJERIUT  
SEKSIONI I PARË

**ÇËSHTJA QERIMI DHE CANAJ kundër  
SHQIPËRISË**  
(Ankimet nr. 12878/10 dhe 74858/12)

**VENDIM  
STRASBURG  
8 shtator 2016**

Ky vendim është i formës së prerë, por mund të bëhet objekt për rishikim redaktues

Në çështjen Qerimi dhe Canaj kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Parë), e mbledhur si një Komitet i përbërë nga:

Aleš Pejchal, *president*,  
Ledi Bianku,  
Armen Harutyunyan, *gjyqtarë*,  
dhe Abel Campos, *regjistruer* i Seksionit,  
Pasi kanë diskutuar me dyer të mbyllura, më 10 maj 2016,

Pasi kanë vërejtur se çështja ligjore në ankesat e mëposhtme tashmë është objekt i një praktike gjyqësore të mirëpërcaktuar të Gjykatës (shiko *Manushaqe Puto dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, nr. 604/07, 43628/07, 46684/07 dhe 34770/09, § 31 korrik 2012),

Lëshon vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë datë:

PROCEDURA

1. Çështja filloi me dy ankime (nr. 12878/10 dhe 74858/12), kundër Republikës së Shqipërisë paraqitur në Gjykatë nga dy shtetas shqiptarë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”). Detajet e ankuesve përcaktohen në shtojcën nr. 1, bashkangjitur vendimit.

2. Qeveria e Shqipërisë (“Qeveria”) u përfaqësua nga Agjencija e saj e asaj kohe, znj. A. Hicka nga Zyra e Avokatit të Popullit.

3. Më 20 dhjetor 2013, ankimet iu komunikuan Qeverisë.

4. Ankuesit nuk paraqitën pretendime për kompensim të drejtë brenda afatit kohor të lejuar (Rregulli 60 i Rregullores së Gjykatës).

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

**A. Ankimi nr. 12878/10: Qerimi**

5. Më 1 nëntor 2002, Komisioni i Durrësit për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave (“Komisioni”), midis të tjerave, i njohu ankuesit të drejtat mbi pronën e trashëguar mbi një sipërfaqe toke me përmasat 8,000 m<sup>2</sup>. Duke qenë se sipërfaqja ishte e zënë, ankuesi dhe trashëgimtarët e tjerë do të kompensohej në natyrë me një sipërfaqe toke ekuivalente.

**B. Ankimi nr. 74858/12: Canaj**

6. Më 23 nëntor 2001, Komisioni i Fierit, midis të tjerave, i njohu ankuesit të drejtat mbi një sipërfaqe toke të trashëguar me sipërfaqe prej 1,121 m<sup>2</sup>, nga e cila u rikthyen 598 m<sup>2</sup>. Duke qenë se sipërfaqja prej 523 m<sup>2</sup> ishte e zënë, ankuesit dhe trashëgimtarëve të tjerë do t’u akordohej një kompensim në shumën 251,040 lekë (“TË GJITHA”).



## II. LIGJI PËRKATËS VENDAS

7. Ligji dhe praktika përkatëse vendase përshtohen në detaje në, *inter alia*, vendimin Ramadhi kundër Shqipërisë (nr. 38222/02, 13 nëntor 2007); *Manushaqe Puto dhe të tjerët kundër Shqipërisë* (nr. 604/07, 43628/07, 46684/07 dhe 34770/09, §§ 23–53, 31 korrik 2012) dhe, së fundmi, *Sharra dhe të tjerët kundër Shqipërisë* [Komiteti] (nr. 25038/08, 64376/09, 64399/09, 347/10, 1376/10, 4036/10, 12889/10, 20240/10, 29442/10, 29617/10, 33154/11, dhe 2032/12, §§ 33–43, 10 nëntor 2015).

## III. MATERIALET E KËSHILLIT TË EVROPËS

8. Materialet që kanë lidhje me këtë çështje u referuan në vendimet e kësaj Gjykate: *Sharra dhe të tjerët*, cituar më sipër, § 44; *Metalla dhe të tjerët kundër Shqipërisë* [Komiteti] (nr. 30264/08, 42120/08, 54403/08 dhe 54411/08, §§ 15–17, 16 korrik 2015); dhe *Karagozi dhe të tjerët kundër Shqipërisë* [Komiteti] (nr. 25408/06, 37419/06, 49121/06, 1504/07, 19772/07, 46685/07, 49411/07, 27242/08, 61912/08, dhe 15075/09, §§ 36–38, 8 prill 2014).

## LIGJI

### I. BASHKIMI I ANKIMEVE

9. Duke qenë se të dy ankuesit ngritën të njëjtën problematikë, Gjykata vendas se ata duhen bashkuar sipas Rregullit 42 § 1 të Rregullores së Gjykatës.

### II. SHKELJE TË PRETENDUARA TË NENEVE 6 § 1 DHE 13 TË KONVENTËS, SI DHE NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR. 1 TË KONVENTËS NË LIDHJE ME MOSZBATIMIN E VENDIMEVE TË FORMËS SË PRERË

Ankuesit pretendonin se ka pasur një shkelje të nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës në lidhje me moszbatimin e vendimeve vendase të formës së prerë, të cilat i akordonin atyre kompensim në vend të rikthimit të pronave të tyre. Gjykata ngriti mocionin e saj për faktin nëse ka pasur një shkelje të neneve 6 § 1 dhe 13 të Konventës.

Neni 6 § 1 i Konventës, për sa ka të bëjë me çështjen, parashikon si më poshtë:

“Në përcaktimin e të drejtave civile dhe detyrimeve ... çdo njeri ka të drejtën për një seancë... dëgjimore... nga [një] ... tribunal...”

Neni 13 i Konventës parashikon si më poshtë:

“Çdonjëri të drejtat dhe liritë e të cilit, siç parashikohen në Konventë, janë thyer, do të përfitojë një kompensim efektiv përpara një autoriteti kombëtar, pavarësisht faktit se thyerja mund të jetë bërë nga persona me një pozicion zyrtar.”

Neni 1 i protokollit nr. 1 i Konventës parashikon si më poshtë:

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe për kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e një Shteti për të zbatuar ligje, që ai i çmon të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.”

### A. PRANUESHMËRIA

11. Qeveria nuk kundërshtoi pranueshmërinë e këtyre çështjeve.

12. Gjykata thekson se këto ankesa nuk janë të pabazuara në fakte sipas interpretimit të nenit 35 § 3 (a) të Konventës. Më tej ajo thekson, se ato nuk janë të papranueshme sipas ndonjë argumenti tjetër. Kështu, ato duhet të deklarohen të pranueshme.

### B. Cilësitë

13. Gjykata nuk debatoi në lidhje me pakënaqësitë e ankuesve dhe pranoi se ankimet ishin objekt i praktikës ligjore të mirëpërcaktuar, sipas vendimit të çështjes *Manushaqe Puto dhe të tjerët* cituar më sipër.

14. Duke marrë në konsideratë gjetjet në çështjet e mëparshme kundër Shqipërisë, për të cilat Qeveria nuk parashittoi ndonjë argument, që mund të shkaktonte shkëputje prej tyre (shiko, midis të tjerave *Çausb Driza kundër Shqipërisë*, nr. 10810/05, §§ 87–89 dhe §§ 91–94, 15 mars 2011; *Manushaqe Puto dhe të tjerët*, cituar më sipër, §§ 93–97 dhe referencat cituar në të; dhe së fundmi, *Sharra dhe të tjerët*, cituar më sipër, §§ 49–51; *Metalla dhe të tjerët*, cituar më sipër, §§ 29–31; dhe *Siliqi dhe të tjerët*, cituar më sipër, §§ 19), Gjykata konstaton se moszbatimi i vendimeve vendase të formës së prerë nga ana e autoriteteve vendase dhe siç vihet re edhe mospagimi i kompensimit të dhënë, shkelte të drejtat e ankuesve bazuar në nenin 6 § 1 dhe në nenin 1 të protokollit nr. 1 të Konventës.



15. Gjithashtu, Gjykata përfundon se nuk kishte, dhe vazhdon të mos ketë, shpërblime efikase vendase, të cilat mundësonin një rregullim të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për moszbatimin e tejzgjatur të vendimeve vendase të formës së prerë, të cilat akordonin kompensim. Kështu, ka një shkelje të nenit 13 të Konventës (shiko *Manushaqe Puto dhe të tjerët*, cituar më sipër, §§ 72–84 dhe referencat e cituara në të).

### III. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

16. Neni 41 i Konventës parashikon:

“Nëse Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të Protokolleve në të, dhe nëse ligji i brendshëm i Palës së Lartë Kontraktuese në fjalë lejon që të bëhet vetëm kompensim i pjesshëm, nëse është e nevojshme, Gjykata duhet të ofrojë kompensim të drejtë për palën e dëmtuar.”

107. Ankuesit nuk parashtruan kërkesat për kompensim të drejtë brenda afatit kohor të lejuar. Për këtë arsye, Gjykata është e mendimit se nuk duhet akorduar dëm monetar. Megjithatë, Gjykata mendon se Qeveria duhet të sigurojë pagesën e një forme kompensimi efikase për ankuesit në lidhje me sipërfaqet e tokës, në përputhje me vendimet e Komisionit dhe me pjesën e pronës së ankuesve, brenda tre muajve (shiko, për shembull, *Vukelić v. Montenegro*, nr. 58258/09, § 107, 4 qershor 2013; *Mikhaylova dhe të tjerët kundër Ukrainës*, nr. 16475/02,

§ 40, 15 qershor 2006; dhe *Lisyanskij kundër Ukrainës*, nr. 17899/02, § 34, 4 prill 2006).

### PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME,

1. *Vendos* t'i bashkojë të gjitha ankimet;

2. *I deklaron* ankimet në lidhje me nenet 6 § 1 dhe 13 të Konventës, si edhe të nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës në lidhje me moszbatimin e vendimeve vendase të formës së prerë të pranueshme;

3. *Gjykon* se ka pasur një shkelje të neneve 6 § 1 dhe 13 të Konventës, si edhe të nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës për sa ka të bëjë me moszbatimin e vendimeve vendase të formës së prerë;

4. *Gjykon* se Shteti i paditur duhet të garantojë, me anë të mjeteve të duhura, zbatimin e vendimeve të Komisionit të dhënë në favor të ankuesve, brenda tre muajve.

Përgatitur në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 8 shtator 2016, sipas Rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

**Abel Campos**

Regjistruer

**Aleš Pejchal**

President

### SHTOJCA 1 LISTA E ANKUESVE

Nr.	Emri dhe no. i çështjes	Emri i ankuesve (viti i lindjes)	Shteti i vendbanimit	Përfaqësuar nga:	Data e prezantimit
1.	<i>Qerimi kundër Shqipërisë</i> , nr. 12878/10	Ahmet Qerimi (1933)	Shqipëri	Askush	10 shkurt 2010
2.	<i>Canaj kundër Shqipërisë</i> , nr. 74858/12	Mero Canaj (1944)	Shqipëri	Askush	19 qershor 2009

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2016

Adresa:  
Bulevardi “Gjergj Fishta”  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”  
Tel: 042427005, 042427006

Çmimi 112 lekë